



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:263211
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639065

A.nr.2781/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit B.SH. nga ..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat ..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurave Kompania Rajonale e Ujësjetësit “Prishtina”, Sh.a, me seli në Prishtinë dhe Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, përfaqësuar nga Dalmat Hyseni, lidhur me anulimin e vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të paditësit, dhe përfaqësuesit të paditurës ARRU dhe në mungesë të palës së paditur KRU Prishtina Sh.a, me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit ... nga
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me numër 186/21, me nr. prot.397/02/21 datë 21.10.2021 dhe vendimi 245090/2021, i datës 19.05.2021 dhe Njoftimi i datës 01.11.2021i të paditurës KRU “Prishtina” Sh.a .
- III. DETYROHET** e paditura Kompaninë Rajonale të Ujësjetësit “Prishtina”, Sh. A, që të shlyej borxhin e parashkruar të ngarkuar në emër të paditësit për periudhën nga viti 01.01.2000 e deri më 28.02.2023 dhe ti lejohet regjistrimi me ujëmatës të ri.
- IV.** Ky aktgjykim zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter të detyrueshëm.
- V.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetimi

Paditësi me datën 23.11.2021 në gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e ujit dhe KRU “Prishtina”, Sh.a, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës me numër 186/21, me nr. prot.397/02/21 datë 21.10.2021 dhe vendimi 245090/2021, i datës 19.05.2021. paditësi ka theksuar se që nga blerja e ngastrës kadastrale numër P-71914002-00474-1, me sipërfaqe prej 299 m², në ZK Hajvali, e ka në shfrytëzim dhe posedim. I cili ka rrënuar shtëpinë e cila ka qenë në ngastrën e blerë e pastaj ka ndërtuar shtëpinë e re. Pa ndërtimit ka shkuar tek e paditura KRU “Prishtina” Sh.a, me qëllim të instalimit të ujëmatësit, por që kjo kërkesë nuk i është aprovuar për faktin se i njëjti obligohet të paguaj borxhin e mëhershëm të krijuar nga viti 2000. Paditësi me ankesë i drejtohet të paditurës ARRU duke kundërshtuar vendimin e shkallës së parë të datës 19.05.2021. E paditura ARRU me vendimin numër 186/21, të datës 19.10.2021, ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit lidhur me kontestimin e borxhit dhe anulimin e vendimit të datës 19.05.2021. Borxhi i kontestuar nga paditësi është

për faktin se borxhi është krijuar nga dikush tjetër e jo paditësi si dhe shuma paushall e tarifuar nuk paraqet obligim për paditësin pasi që asnjëherë në adresën e tij nuk është dërguar ndonjë faturë nga e paditura.

Përfaqësuesi i paditësit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit të ushtruar pranë kësaj gjykate, duke kundërshtuar përgjigjet në padi të të paditurave, vendimet e të paditurave nuk janë të ligjshme, pasi që vlerësojmë se nuk i plotësojnë kushtet sipas nenit 47 dhe 48 të LPA, të paditurat kanë pasur mundësinë e bartjes së borxhit për parcelën e njëjtë tek këtu paditësi, mirëpo një gjë të tillë nuk e kanë bërë duke insistuar në lidhjen e një marrëveshje për pranimin e borxhit, mirëpo paditësi nuk mund të prani një gjë të tillë, për shkak se një pjesë e borxhit ka qenë borxh i falur sipas Ligjit, ky borxh është ri programuar nga viti 2000 e tutje, por që borxhi i kërkuar në tërësi është bërë i parashkruar, andaj e paditura ARRU, është dashur që përmes Vendimit të aprovoi ankesën dhe ta liroi palën nga borxhi i parashkruar, për shkak se edhe në ankesë pala paditëse është thirrur në këtë bazë të parashkruar. Andaj krejt kjo ka të bëjë me borxhin nga viti 2000 e deri më tani sepse e paditura e parë KRRU Prishtina, nuk ka kërkuar realizimin e borxhit përmes procedurave ligjore, përmes padisë apo procedurës përmbarimore, andaj në ri vendosje duhet ti kenë parasysh afatin një vjeçar të parashkrimit. Sa i përket të paditurës së dytë, pasi që e njëjta në bazë të Vendimit nr.096/21, e kthen në rivendosje çështjen tek e paditura e parë, që të bëhen rregullimet e kode të konsumatorit, mirëpo e paditura e parë KRU Prishtina, nuk e ka bërë një gjë të tillë, dhe përmes Ankesës së dt. 21.09.2021, paditësi i është drejtuar ARRU përsëri me ankesë, për shkak se e paditura e parë nuk e ka marrë parasysh, nuk ka vepruar sipas vendimit të ARRU me të cilën lënda është kthyer në ri shqyrtim. Në këtë raste paditura e dytë ARRU ka marrë Vendim nr.186/21 duke aprovuar pjesërisht ankesën mirëpo për paditësin ky vendim përsëri nuk i realizon të drejtat e këtij vendimi. Në bazë të vendimit të shkallës së dytë e paditura ARRU është refuzuar periudha e borxhit që figuron nga vitit 2000 deri në muajin Maj/2018, është rregulluar borxhi për periudhën 2018/2019, dhe kjo periudhë nuk është kontestuese, dhe vazhdon të jetë periudha kontestuese 2019 e tutje, dhe kjo periudhë si tërësi me përjashtim të periudhës Maj/2018, Maj/2019 në tërësi është bërë i parashkruar, dhe këto rregullime besojmë që duhet ti bëjë e paditura e dytë. Vlen të theksohet për gjykatën se paditësi pronën, në të cilën ka qenë i vendosur njehsori—ujëmatësi, e ka blerë sipas kontratës së shitblerjes në vitin 2013, nga personi ..., por që borxhi sipas ujëmatësit-njësorit, është në emër të ..., ku ky borxh figuron nga vitit 2000 e tutje, kjo periudhë e borxhit e evidentuar në emër të ..., është bartur në bazë të Ujëmatësit, në pronën që e ka blerë paditësi, por që si duket pas stërshitjes së pronës, asnjëherë nuk është bartur edhe fatura e ujësjellësit, edhe pse paditësi ka bërë kërkesë tek e paditura e parë, për regjistrim me ujëmatës të ri mbi rregullimin e shtëpisë së tij, që të jetë në mënyrë të rregull në lidhje me shërbimet e ujit, mirëpo e paditura KRU Prishtina, e ka njoftuar paditësin se me këtë nr. të parcelës ekziston shifra e ujëmatësit të mëhershëm 67285, dhe ka borxhe të pa shlyera dhe pa shlyerjen e këtyre borxheve nuk mund të regjistrohet ujëmatës i ri në emër të paditësit, më dt.23.03.2021 me Inspektim nga e paditura e parë, është vërtetuar se ekziston ujëmatës i mëhershëm, dhe njëkohësisht konsumatori-paditësit i është sugjeruar që të bëjë borxhin e themeluar, dhe vetëm atëherë do të kaloi në emër të paditësit ujëmatësi i ujit. Edhe sot kjo gjendje e njëjtë vazhdon, paditësit nuk i është regjistruar ujëmatësi i ri, andaj tani i propozojmë gjykatës që të anulohen të dy vendimet e atakuara, dhe në lidhje me njehsorin 67285, të konstatohet në tërësi si b borxh i parashkruar, duke u liruar paditësi nga ky borxh dhe të obligohet e paditura e parë që paditësi ..., të lirohet nga borxhi në emër të personit tjetër ..., si dhe të lejohet regjistrimi i Ujëmatësit të ri në emër të paditësit

E paditura KRU “Prishtina”Sh.a në përgjigje në padi të datës ka deklaruar: e kundërshton padinë e paditësit në tërësi, me arsyetimin se paditësi në aspektin subjektiv padinë e ka dorzuar gabimisht, për shkak se Vendimin e fundit Nr.186/21 të dt;19.10.2021 e ka nxjerrë organi mbikqyrës si ofruesit të shërbimeve që si shkallë e dytë dhe po e njëjta paditësin e kishte njoftuar tek këshilla juridike. Sipas vendimit të nxjerr nga Autoriteti Rregullator për shërbime të ujit në Kosovë e paditura me datën 01.11.2021 e kishte zbatuar vendimin e ARRU-së ku e kishte njoftuar Konsumatorin lidhur me korrigjimin e borxhit sipas vendimit të KZAK-ARRU, nr.186/21.dt;21.10.2021,ndërsa pjesën tjetër të vendimit e kishte lënë në fuqi. Dhe ka Kërkojmë nga Gjykatës Themelore Prishtine Departamenti Administrativ, që pas shqyrtimit kryesor dhe administrativ të provav të bie vendim,me të cilin padinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar dhe të pa argumentuar.

Përfaqësuesi i të paditurës ARRU në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, Komisioni për zgjedhjen e ankesave me seriozitet ka shqyrtuar ankesën e paditësit, dhe për vërtetim të drejtë të gjendjes faktike e ka kthyer rastin në rivendosje, dhe ka qenë e detyruar që me vendimin e atakuar në padi, ankuesit ti rregulloi vetëm faturimin paushall nga Maji/2018 deri Maj/2019, periudhë në të cilin faturimi ka qenë i pa ligjshëm dhe në kundërshtim me Rregulloren 02/2016, për standarde minimale të KRRU Kosovë, dhe Rregulloren 08/2018, për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së lartpërmendur, sa i përket çështjes së parashkrimit, konsiderojmë se kjo çështje nuk ka qenë pretendim i palës në të dy shkallët në të cilat është trajtuar ankesa, ky pretendim konsiderojmë se është i parakohshëm

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor, ka administruar provat relevante: Procesverbali mbi rindërtimin e informacioneve kadastrale, dt.23.08.2013, nga MMPH, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Faturë e dt. 22.03.2021, nga KRU, ‘Prishtina’, në emër të ..., Kontratë e shërbimeve të Ujit, në mes të KRU Prishtina, dhe Bajram Rashitit, Nr. kontratës C-035647, dt. 23.03.2021, Vendim nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Nr.186/21, dt. 19.10.2021, Kartelë Financiare e Konsumatorit dt.01.01.2013 - 01.11.2021, në emër të ..., Kartelë Financiare e Konsumatorit dt.01.01.2013 - 01.03.2023, në emër të ..., Kartela e Matësit, nga data 01.01.2021, deri 01.09.2021, në emër të ..., Kartela e Matësit, nga data 01.01.2021, deri 01.03.2021, Njoftim lidhur me korrigjimin e borxhit sipas vendimit të KSAK – ARRU, 01.11.2021, Formulari i Ankesës konsumatorit për shërbimet e Ujit, nr.205, e dt. 02.06.2021, Ekstrakt na Librat e Kontabilitetit periudha 2006-2014, nga e paditura KRU Prishtinë, Ekstrakt na Librat e Kontabilitetit 2004-2005, Ekstrakt na Librat e Kontabilitetit 2005-2006, Ekstrakt na Librat e Kontabilitetit 2003-2004, Ekstrakt na Librat e Kontabilitetit 2002-2003, Kartela Financiare e Konsumatorit 01.01.2013 - 23.09.2021, Procesverbal për kontroll dhe Inspektim dt.23.03.2021, nga e paditura KRU Prishtina, Foto të orëmatësit (tri kopje), Kartelë Financiare e Konsumatorit dt.01.01.2013 - 01.03.2023, Fatura e Tatimit në Pronë, 2020, në emër të ..., dt.17.01.2021, Vendim i dt.19.10.2021, nga Autoriteti Rregullator për shërbime të Ujit, dt. 21.10.2021, Procesverbal Komisioni për zgjedhjen e Ankesave, pranë të paditurës ARRU edt.19.1021, Vendim Kodi: 67285, dt.16.08.2021, Procesverbal për shqyrtimin e ankesës, dt.28.07.2021, nga KRU Prishtina, Vendim i dt.23.06.2021 nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Formulari i Ankesës/Kërkesës Konsumatorit, dt. 23.03.2021, Vendim i dt. 19.05.2021, Ankesë 02.06.2021, Raporti detal mbi ankesën e dt. 24.09.2021, 28.07.2021, Faturë me nr. P1790667, Njoftim lidhur me korrigjimin e borxhit sipas vendimit të KZAK – ARRU, NR.186/21, DT.21.10.2021,

Me vendimin nr.245090, të datës 19.05.2021, gjykata vërtetoi se e paditura KRU “Prishtinë” Sh.a, ka refuzohet si të pabazuar kërkesën për regjistrimin e lidhjes së re në shërbimet e ujësjellësit

E pa kënaqur me vendimin e lartcekur paditësi ka ushtruar ankesë tek organi i shkallës së dytë.

Me vendimin nr.186/21, të datës 19.10.2021.2021, gjykata vërtetoi se e paditura ARRU, ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit lidhur me kontestimin e borxhit dhe ka anuluar vendimin e KR|U “Prishtina”, nr. 245090/21, të datës 19.05.2021. Dhe ka obliguar KRU “Prishtina”, që të rregulloj faturimin në tarifë fikse nga muaji 05/2018-05/2019.

E pa kënaqur me vendimin e lartcekur paditësi ka ushtruar padi në gjykatë

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata duke pasur parasysh shkresat e lëndës, në drejtim të vërtetimit të pretendimit të paditësit për parashkrimin e borxhit, dhe atë duke marr për bazë vendimin e ARRU nr.186/21 i dt.19.10.2021, vendimi nr.245090/21 i datës 19.05.2021 i KRU Prishtina, ankesën e datës 07.05.2021, faturën me shifër 67285, në emër të Bajram Rashitit të datës 22.03.2021, kartelën financiare të konsumatorit për periudhën 2002-2003, kartela e ujëmatësit për periudhën 2003-2004, Ekstrakti nga librat e kontabilitetit 2004-2005,

Ekstrakti nga librat e kontabilitetit 2005-2006, Ekstrakti nga librat e kontabilitetit 2006-2014, Kartela financiare e konsumatorit në emër të ... për periudhën 01.01.2013-01.11.2021, Kartela financiare e konsumatorit në emër të ... për periudhën 01.01.2013-01.03.2023, ka konstatuar se borxhi i kontestuar në shumën prej 2,172.80 euro është borxh i parashkruar dhe në emër të konsumatorit ... dhe ka të bëjë me periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2023.

Deri te ky konstatim gjykate erdhi duke pasur parasysh Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) , i cili me nenin 341 ka përcaktuar se kur krijohet parashkrimi:” 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Ndërsa me nenin 343 të LMD përcaktohet: ” Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj”.

Më pas gjykata iu referuar neni 360 par 1 ku është përcaktuar se cilat kërkesa parashkruhen: kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti janë: “1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;” dhe paragrafit 2 “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.

Po ashtu gjykata pati parasysh dispozitat e LMD të cilat kanë të bëjnë me NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT dhe atë nenin 368 të LMD në të cilin dispozitë është përcaktuar:”1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.

Andaj marr për bazë dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe bazuar në provat e administruara rezulton se borxhi i krijuar nga viti 2002 ku është faturuar në emër të ... dhe se paditësi edhe në padi por edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor përmes përfaqësuesit të tij ka deklaruar se nuk është krijuar shpenzimi i ujit nga paditësi Po ashtu nga kartela financiare e konsumatorit, rezulton se në emër të ... është faturuar borxhi, ndërsa paditësi nuk ka paguar asnjë borxh të faturuar, për shkak se uji nuk ka qenë i shpenzuar nga paditësi dhe asnjë herë nuk i është dorëzuar fatura e shpenzimeve të ujit kështu që ka ngel në tërësi ky borxh.

Gjykata ka konstatuar gjithashtu se e paditura KRU “Prishtina” Sh.a dhe as e paditura ARRU me asnjë prova nuk kanë vërtetuar se janë ndërmarr veprim lidhur me kërkesën e përmbushjes së borxhit, qoftë me parashkrimin e padisë apo ndonjë veprim tjetër ligjor, duke qenë se në nenin 369 të LMD është përcaktuar: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”, kurse me nenin 372 të LMD përcaktohet:” Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”.

Andaj nga arsyet e paraqitura, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit referuar parashkrimit dhe se borxhi i faturuar paditësit në bazë të provave siç janë kartelat financiare të konsumatorit dhe ekstraktit nga librat e kontabilitetit janë në emër të ... është i bazuar, dhe mbi këto arsye gjykata ka vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit duke i'u referuar kompetencës së gjykatës në nenin 9 dhe 43 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke qenë se ka vendosur për ligjshmërinë e vendimit përfundimtar administrativ dhe duke pasur parasysh kompetencën e këtu ta paditurës si autoritet përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesve të shërbimeve dhe duke mare parasysh se e paditura Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina”, si organ i shkallës së parë është ofrues i shërbimeve dhe e njëjta është përcaktues i borxhit të parashkruar.

Gjykata, me rastin e vendosjes vlerësoi edhe pretendimet e të paditurave dhe të njëjtat i refuzoi si të pa bazuara, për faktin se e paditura KRU “Prishtina”, borxhin e faturuar në emër të paditësit është dashur që ta kërkon nga konsumatori ... i cili edhe ka qenë pronar i ujëmatësit i regjistruar si konsumator me shifër-kod 67285, brenda afateve ligjore, e jo që paditësit mos ti lejohet regjistrimi me orëmatës të ri për shkak

të borxhit i cili figuron në orëmatësin e vjetër në emër të personit tjetër për shifrën –kodin e vjetër. Po ashtu e paditura është dashur që të verifikoj se prej cilës periudhë në bazë të kontratës së shitblerjes së ngastrës kadastrale është bërë ndryshimi i pronarit të ngastrës dhe prej asaj kohe të njoftohet konsumatori i ri për ndryshime të konsumatorit dhe faturimi për shpenzimet e ujit të bëhet në emër të pronarit të ri duke ia lejuar qasjen edhe për ndryshime dhe regjistrime të reja me orëmatës të ri. Ndërsa borxhi për shpenzime të ujit për periudhën kontestuese të shlyhet për faktin se është borxh i parashkuar.

Lidhur me shpenzimet procedurale u vendos në kuptim të nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 43.3, 46.2.4.5, lidhur me nenet 5, 6, 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 2781/2021, datës 24.04.2024

G j y q t a r j a
Valbona Gjonbalaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.